



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700324/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda : Rekomandohet marrja e masave për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative kundra Ministrisë së Mbrojtjes me objekt rivendosje në afat të kërkesës për njohjen e Dëshmorit të Atdheut, shtetasit I. P. i vrarë në krye të detyrës me datë 19.04.2003.

Drejtuar : **Z. KASTRIOT SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijeni : **Znj. Valentina AGOLLARI**
Lagj Nr.13, Rr. "Kuço Drenova"
Pallati Nr.10, Shk.D/3

KORÇË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e saj datë 13.03.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetësja V. A. nga qyteti i Korçës, ankohet për shkeljen e procedurave gjyqësore dhe zvarritjen e gjykimit pa shkaqe ligjore të një çështje administrative kundra Ministrisë së Mbrojtjes Tiranë me objekt rivendosje në afat të kërkesës për njohjen Statusit të Dëshmorit të Atdheut, shtetasit I. P. i cili është vrarë në krye të detyrës me datë 19.04.2003 nga shtetasi O. M. i cili është gjykuar e dënuar penalisht nga Gjykata e Lartë me datë 04.12.2013 me 17 vjet burgim në bazë të nenit 77/1 të K.P.U.

Nga verifikimi i kryer nga ana jonë rezultoi se ndaj vendimit nr.5280 datë 22.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është bërë ankim nga palët dhe në bazë të shortit datë 18.04.2016 për rishortimin e çështjes me datë 21.04.2016 dosja gjyqësore i ka kaluar për gjykim trupës gjyqësore me kryesus Z.Amarildo LAÇI, cili nuk e ka planifikuar akoma për gjykim.

Ankuesja na shkruan se kur u vra nipi i saj shtetasi I. P. nga Komanda e Repartit Ushtarak na u tha se nipi është vrarë në krye të detyrës, dhe si i tillë ai do njihet si Dëshmorit të Atdheut, dhe me këtë rast nga organet e shtetit nipit ju bënë të gjitha nderet dhe respektet që i takonin. Personi që e vrau është gjykuar dhe dënuar nga gjykata dhe pasi janë përfunduar të gjitha procedurat gjyqësore ai u dënua përfundimisht me 17 vjet burgim.

Ne nga ana tjetër në bazë të kërkesave të Ligjit me Nr.8607 datë 27.04.2000 "Për Statusin e "Dëshmorit të Atdheut", kemi vazhduar rrugën ligjore për njohjen e statusit të Dëshmorit të Atdheut, dhe Komisioni kompetent shtetror në kundërshtim me të gjitha kërkesat e ligjit ka vendosur rrëzimin e kërkesës tonë pa na njoftuar fare. Në fillim nga

Komisioni na thuhej se nuk kanë përfunduar procedurat gjyqësore të cilat kanë përfunduar nga Gjykata e Lartë Tiranë, me vendimin datë 04.12.2013.

Po kështu ankuesja na shkruan se Komisioni nuk ka mbajtur parasysh faktin kryesor se shtetasi I. P. është vrarë me dashje në krye të detyrës në ushtri, dhe faktin tjetër se personi që e ka vrarë atë O.M., është dënuar me 17 vjet burgim, se nipi I. P. ka qënë ushtar i shërbimit të detyrueshëm ushtarak i mobilizuar nga shteti sipas legjislacionit në fuqi, se për shpalljen e tij Dëshmor i Atdheut, ka marrë vendim edhe Këshilli i Qarkut Korçë, etj dhe për mendimin tonë ka vend për zgjidhjen në themel të këtij problemi shqetësues dhe të ligjshëm.

Në këto kushte, dhe duke analizuar të gjitha rrethanat e këtij rasti, mendojmë se ky rast duke u konsideruar *si rast i veçantë* nga institucioni ynë u mendua të ndërhyhet pranë Jush me rekomandim për shpejtimin e procedurave gjyqësore të gjykimit sa më shpejtë në të ardhmen në bazë të kërkesave të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet qartë se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të Drejtave të Njeriut, nga administrata publike”.

Po kështu në nenin 25 të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, thuhet se:”Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të të Drejtave të Njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e Gjykatës në marrjen e vendimit.

Për sa sipër Ju,

REKOMANDOHET :

1. Shpejtimi i procedurave gjyqësore të gjykimit të çështjes administrative midis ankuses V. A. dhe e Paditur Ministria e Mbrojtjes me objekt rivendosja në afat.
2. Mbi msat e marra nga ana juaj në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit prej 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI